



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

## GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2023:005626  
Datë: 07.02.2024  
Numri i dokumentit: 05296115

**CAP.nr.116620/23**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, nga gjyqtarja individuale Naime Ahmeti, në çështjen përmbarimore të kreditores Komuna e Mitrovicës, të cilën sipas autorizimit e përfaqësoj L.Z., avokat nga Prishtina, ndaj debitorit Q.B., nga Mitrovica, Rr. “A..... J.....”, me bazë juridike pagesë borxhi, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditores, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PPP.nr.3/23 të datës 18.05.2023, më datë 07.02.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

Aprovohet si e themeltë ankesa e të autorizuarit të kreditores Komuna e Mitrovicës, anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PPP.nr.3/23 i datës 18.05.2023 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin PPP.nr.3/23 të datës 18.05.2023, në pikën një të dispozitivit ka aprovuar prapësimin e debitorit Q.B., nga Komuna e Mitrovicës të ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.1130/22 të datës 27.10.2022. Në pikën dy, ka shfuqizuar urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.1130/22 të datës 27.10.2022, duke abroguar të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore.

Kundër këtij vendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditores, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale dhe zbatimit të gabuar të ligjit material, me propozim që të aprovohet ankesa e kreditores, të anulohet vendimi i gjykatës së shkallës së parë PPP.nr.3/23 i datës 18.05.2023 dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, ashtu që në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

-Ankesa është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditorja ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbartues-vendimit administrativ të nxjerr nga Komuna e Mitrovicës me datë 06.04.2022, lidhur me pagesën e tatimit në pronë në shumë prej 19,062.13 euro. Përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin e kërkuar me urdhrin P.nr.XXX/22 të datës 27.10.2022, nda të cilit urdhër debitori ka paraqitur prapësim me datën 06.12.2022, ndërsa kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datën 22.12.2022. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimin dhe përgjigjes në prapësim vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 të LPK-së, lidhur me nenin 36 të LPP-së, si dhe nenit 22, paragrafi 1, pika 1.2 e lidhur me nenin 24 të LPP-së.

Kjo Gjykatë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vepruar kur e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit me arsyetimin se dokumenti përmbartues nuk i plotëson kushtet ligjore dhe se i njëjti është i pa përshtatshëm për përmbartim. Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, qartë përcaktohet se organi përmbartimor e cakton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues dhe dokumentit të besueshëm. Në rastin konkret, procedura përmbartimore është iniciuar në bazë të dokumentit përmbartimor siç parashihet me dispozitën e nenit 22 të LPP-së, përkatësisht paragrafi 1, pika 1.2 të këtij neni, ku si dokument përmbartimor ndër tjera konsiderohet edhe *vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia)*. Më tutje, sipas nenit 23, paragrafi 2 të LPP-së, parashihet se *“vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendim dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument përmbartimor, i dhënë nga organi i ngarkuar me autorizime publike siç është vendimi i Komunës së Mitrovicës i datës 06.04.2022, ndërsa neni 24 paragrafi 3 të LPP-së me të cilin përcaktohet se: “Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbartimor, po që se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.”*, dhe i përmban kërkesat nga neni 27 paragrafi 1 të LPP-së, me të cilin ku përcaktohet se: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Me dispozitën e nenit 24 paragrafi 5 të LPP-së përcaktohet se: *“Përmbartimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në*

*procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po që se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbarrimin”, ndërsa me dispozitën e nenit 144 paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet se: “Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues”, po ashtu sipas dispozitës së nenit 30, paragrafi 5 të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme parashihet se: “Vendimi për ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara përbën titull ekzekutiv...”. Në bazë të dokumentit përmbarrues të datës 06.04.2022, përcaktohet se: pagesa duhet të bëhet brenda 10 ditëve nga pranimi i vendimit në llogarinë bankare në të kundërtën vendimi paraqet titull ekzekutiv dhe procedura mund të vazhdoj përmes përmbarruesit privat, ndërsa në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës vendimi i datës 06.04.2022, është pranuar nga debitori me datën 13.04.2022. Andaj, në bazë të cekurave aktvendimi i atakuar u deshtë që të anulohet dhe çështja të kthehet në procedim të serishëm.*

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh vërejtjet e cituara më lartë, të vlerësoj dokumentin përmbarrimor duke i eliminuar të metat e theksuara, në rast të paqartësive të caktoj seancë dëgjimore konform nenit 73 të LPP-së, të konstatojë nëse ekziston parashkrimi e pas kësaj të vazhdoj procedurën konform dispozitave ligjore duke marr aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209 pika d) të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**CAP.nr.1166/2023, më datë 07.02.2024**

**Gjyqtarja**  
**Naime Ahmeti**